

VENDIM
Nr.832, datë 30.11.2011

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z.SADIK DOBI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.993, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në zërin “mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 1 250 000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z.Sadik Dobi.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha